

Rekomandime mbi zbatimin e Programeve të Transparencës në sektorin shëndetësor

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Zyra e Komisionerit") është përgjegjëse për monitorimin dhe mbikëqyrjen e transparencës proaktive të autoriteteve publike.

Në përmbushje të këtij detyrimi ligjor, vlerësohet se institucionet e sistemit shëndetësor publik, për shkak të funksionit, shpërndarjes territoriale dhe shërbimeve që ofrojnë për popullatën, përbëjnë një kategori të rëndësishme të autoriteteve publike.

Konkretisht, autonomia spitalore, si pjesë integrale e menaxhimit të sistemit spitalor publik, garanton barazi, aksesueshmëri, cilësi, siguri dhe ofrimin e shërbimit shëndetësor në kohë për pacientin.

Referuar Ligjit nr. 55/2022 "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë", spitalet autonome organizohen në formën e personit juridik publik, me të drejta, detyrime dhe përgjegjësi të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Autonomia spitalore ka për synim të sigurojë:

- efektivitet dhe transparencë në menaxhimin administrativ të burimeve financiare dhe burimeve njerëzore;
- rritje të transparencës dhe llogaridhënies ndaj qytetarëve;
- përmirësim të mobilizimit të burimeve njerëzore dhe financiare;
- rritje të rolit të komunitetit në vendimmarrje.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit miratoi 12 Rekomandime, me qëllim zbatimin e ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar dhe rritjen e transparencës proaktive të qendrave spitalore/spitaleve rajonale në vend.

Zyra e Komisionerit i rekomandon autoriteteve publike të vënë në zbatim, të publikojnë, të pasqyrojnë, të përditësojnë, të ndërlikojnë në programin e transparencës të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t'u bërë publike, në përputhje me nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, Urdhrit nr. 187, datë 18.12.2020, "Për miratimin e Programit të Transparencës të rishikuar", të ndryshuar, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Rekomandimeve brenda një afati 90 ditë nga momenti i marrjes dijeni të tij.



Rekomandim Nr. 10 - QSUT "Nënë Tereza"

Rekomandim Nr. 11 - QSR "Shefqet Ndroqi"

Rekomandim Nr. 12 - Spitali Universitar i Traumës

Rekomandim Nr. 13 - SUOGJ "Mbretëresha Geraldinë"

Rekomandim Nr. 14 - SUOGJ "Koço Gliozheni"

Rekomandim Nr. 15 - Spitali Rajonal Vlorë

Rekomandim Nr. 16 - Spitali Rajonal Durrës

Rekomandim Nr. 17 - Spitali Rajonal Shkodër

Rekomandim Nr. 18 - Spitali Rajonal Memorial Fier

Rekomandim Nr. 19 - Spitali Rajonal Lezhë

Rekomandim Nr. 20 - Spitali Rajonal Gjirokastrë

Rekomandim Nr. 21 - Spitali Rajonal Korçë

Qasja dhe aksesit në informacion, Dervishi: Zyra e Komisionerit e angazhuar për të rritur transparencën e autoriteteve publike



Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi mori pjesë në takimin e katërt të grupeve tematike të punës mbi qasjen/aksesin në informacion, i organizuar në kuadër të projektit “Promovimi i Lirisë së Shprehjes në Shqipëri përmes Dialogut të Hapur”, i bashkëfinancuar nga BE/Këshilli i Evropës dhe në koordinim me Departamentin e Gazetarisë të Universitetit të Tiranës. Diskutimet u përqëndruan te shkëmbimi i përvojave, situata aktuale, rekomandimet praktike për përmirësimin e aksesit në informacion në vendin tonë.

Komisioneri Dervishi bëri një rezymë të punës së Zyrës, si dhe të performancës së institucioneve në raport me zbatueshmerinë e legjislacionit për të drejtën e informimit. Dervishi solli në vëmendje të grupeve të interesit, se institucioni që ai drejton është i angazhuar për rritjen e llogaridhënies dhe transparencës së autoriteteve publike dhe se ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” duhet promovuar nga të gjithë palët, pasi i përmbush të gjitha kushtet për të qënë i zbatueshëm plotësisht si nga autoritetet publike ashtu edhe nga çdo subjekt kërkuar i informacionit.

Duke u ndalur te situata aktuale, Komisioneri theksoi se aksesit i gazetarëve në informacionin publik ka një rëndësi të veçantë, megjithatë duhet mbajtur parasysh se e drejta e informimit është e ndryshme nga një tjetër e drejtë themelore e individit, liria e shprehjes. Qasja dhe aksesit në informacion është një komponent themelor i qeverisjes demokratike, transparencës dhe llogaridhënies.

Vendimmarrja e Komisionerit

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale gjatë muajit prill 2025 ka dhënë 5 vendime në zbatim të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”).

Sipas Vendimit nr. 8, datë 30.04.2025, Komisioneri ka pranuar ankesën ndaj Autoritetit Publik “Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë” me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.

Ankuesi, me anë të kërkesës datë 03.02.2025, depozituar nëpërmjet shërbimit postar pranë Autoritetit Publik, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

1. Vendimin nr. XXXX, i vitit 2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
2. Akt-Ekspertimin (Topografik) me nr. Akti XXX i vitit 2012.

Autoriteti Publik nëpërmjet shkresës “Kthim përgjigje”, datë 07.03.2025, ka kthyer përgjigje ankuesit duke i sqaruar se: “...nga verifikimet e kryera nuk rezulton të jeni pjesë e këtij procesi gjyqësor dhe në këto kushte nuk mund t’ju vihen në dispozicion aktet e sipërcituara...”.

Ankuesi, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesë.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të LDI.

Në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri nëpërmjet një shkrese zyrtare ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin, apo procedurën e ndjekur, lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Nga shqyrtimi i çështjes, konstatohet se objekti i kërkesës lidhet me vendime të shpallura nga gjykatat e Republikës së Shqipërisë.

Në kuptim të LDI, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë është autoritet publik. Për rrjedhojë, ky autoritet detyrohet për zbatimin e LDI duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Nga përgjigja e kthyer nëpërmjet shkresës “kthim përgjigje”, datë 07.03.2025, Autoriteti Publik refuzon vendosjen në dispozicion të ankuesit, vendimin e shpallur nga kjo gjykatë, me pretendimin se kërkuesi nuk është palë në procesin gjyqësor dhe si pasojë nuk mund t’i vihen në dispozicion aktet. Komisioneri vlerëson se, refuzimi i mësipërm i Autoritetit Publik, është i pa bazuar në ligj. Neni 146 i Kushtetutës së Shqipërisë parashikon shprehimisht në pikën 2 të tij se: “Vendimet gjyqësore shpallen publikisht në çdo rast”.

Për sa me sipër Autoriteti Publik, në shqyrtimin e kërkesës për informim të ankueses, duhet të kishte marrë parasysh vetëm parashikimet e pikës 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit “Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit”.

Autoriteti Publik duhet të tregojë qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim. Autoriteti Publik duhet të kishte vlerësuar kufizimin e pjesëve të cilat sipas gjykimit të tij i nënshtrohen kufizimeve të trajtuara më sipër sipas pikës 6 të nenit 17 të LDI dhe Udhëzimit nr. 15, datë 23.12.2011 “Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor”, duke vendosur në dispozicion ato materiale mbi të cilat nuk ka një shkak ligjor për kufizimin.

Për sa më sipër, informacioni i kërkuar, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI, sipas të cilit “informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”. Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Në përfundim Komisioneri vendosi, pranimin e ankesës dhe urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion.

Për më shumë informacion rreth vendimmarrjes së Komisionerit, lexoni në faqen zyrtare www.idp.al

Shkëmbim eksperience dhe praktikash të mira në fushën e të drejtës për informim



Përfaqësues nga 14 autoritete evropiane për të Drejtën e Informimit u mbledhën në Prishtinë në Takimin e 4-t të Seminarit të Rasteve të Veçanta (Case Handling Workshop).

Nën organizimin e Agjencisë për Informim dhe Privatësi të Republikës së Kosovës, ekspertët e fushës ndanë me njëri-tjetrin eksperiencë dhe praktikat më të mira mbi shqyrtimin e rasteve konkrete me interes publik dhe aksesin në dokumente zyrtare në lidhje me to. Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin përfaqësues nga autoritetet e Mbretërisë së Bashkuar, Gjermanisë, Austrisë, Zvicrës, Portugalisë, Spanjës, Skocisë, Zyrës së Avokatit të Popullit Evropian, Kroacisë, Hungarisë, Sllovenisë, Shqipërisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut.



Gjatë aktivitetit u diskutua, ndër të tjera, mbi çështje që kanë të bëjnë me transparencën në kuadër të zbatimit të legjislacionit mbi mjedisin dhe të drejtave të konsumatorit; mbi procedurat e shpenzimeve me fondet publike dhe partneritetit publik-privat; ofrimin e shërbimeve publike nëpërmjet platformave teknologjike/digjitale; trajtimin e sekretit tregtar apo të drejtës së autorit. Zyra e Komisionerit, në këtë seminar, mbajti një prezantim në lidhje me rastin e trajtimit jo të saktë të konceptit të konfidencialitetit nga autoriteti publik gjatë ushtrimit të kompetencave të tij mbikëqyrëse në raport me transparencën dhe interesin e lartë publik.



Zyra e Komisionerit trajnim koordinatorëve për të drejtën e informimit



Me temë “E drejta për informim-Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve (REKPDJ)”, Drejtoria e Monitorimit të Programe të Transparencës në Zyrën e Komisionerit zhvilloi një trajnim online me koordinatorët për të drejtën e informimit të 25 institucioneve në nivel qendror.

Në këtë aktivitet, pjesëmarrësit u njohën më konkretisht me detyrimin lidhur me publikimin/përditësimin e Regjistrat të kërkesave dhe përgjigjeve, sipas parashikimeve të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, mënyrën dhe funksionet e përdorimit të REKPDJ nëpërmjet portalit pyetshtetin.al. Nëpërmjet këtij të fundit, qytetarët, grupet e interesit/shoqëria civile apo përfaqësues të medias, kanë një instrument më shumë, më efikas dhe më të shpejtë në kërkimin e informacionit/dokumentacionit në funksion të interesit publik

Stafi i Zyrës së Komisionerit, gjithashtu diskutoi me të pranishmit në lidhje me problematika të ndryshme mbi kërkesat për informacion, duke ofruar shembuj sipas praktikave më të mira për adresimin e tyre në kohë dhe në përmbajtje. Veçanërisht, përdorimi i Regjistrat Elektronik të Kërkesave dhe Përgjigjeve lehtëson dhe forcon edhe më tej transparencën proaktive të çdo autoriteti publik, si dhe ndikon në përmirësimin e shërbimeve që u ofrohen qytetarëve apo grupeve të interesit.

